

## POUR EN SAVOIR PLUS SUR LA LAVI : Traduction en albanais

### Çfarë mund t'ju afrojnë qendra Lavi ?

Një vënd ku, ju mund të flisni, një mbështetje – informacione mbi procedurën penale, një shoqërim në punët administrative dhe juridike – një ndihmë materiale në rast nevojë, një orientim drejt shërbimeve të veçanta.

Çdo person që punon në një qendër të konsultimit LAVI është i nënshtruar, **ruajtjes të sekretit profesional**. Konsultimet në qendrat LAVI janë **falas**.

### Çfarë shkele të ligjit ?

- vrasje
- agresione, goditje dhe plagosje
- aksidente të rrugës shkaktuar nga të tjerë persona
- dhunë shtëpiake ose bashkëshortore.

Agresione seksuale :

- përdhunim, ngacmime seksuale pa dëshirën e tjetrit, dhunë bashkëshortore
- Abuzim seksual tek fëmijët, mardhënie seksuale të pa lejuara brënda një familjeje, etj.

Por gjithashtu :

- Kërcënime të rënda, presion moral ose fizik, ushtruar mbi tjetrin
- Sulmim me armë në dorë i organizuar për vjedhje, rrëmbime, vjedhje e organizuar në grup të armatosur
- Gabime mjeksore, etj....

### Mos ngurroni të na thërrisni.

### Ne ju përgjigjemi kërkesave të viktimave direkt ose të afërmëve të tyre.

Çdo person që ka pësuar një akt dhune, **një prekje direkte** në tërësinë e trupit të tij, seksuale ose psiqike, mund të përfitojë një ndihmë sipas ligjit të përghithshëm mbi ndihmën e viktimave të shkeljes së ligjit (LAVI), që autori është ose jo i njohur ose që sjellja e tij është ose jo fajtor.

Bashkëshorti, fëmijët, baballarët e nënat si dhe persona të tjerë të afërt me viktimën, që kanë lidhje të ngjashme si më sipër, janë konsideruar si viktimë jo-direkte që hyjnë në të njëjtin ligj dhe përfitojnë gjithashtu ndihmë nga qendrat LAVI.

Ky ligj rikonfirmon pozitën e viktimës në procedurën penale. **Për të pasur ndihmë nga shërbimet e afuara të një qendre LAVI, nuk ka nevojë të bësh një ankim penal.**

*Traduction non certifiée conforme, réalisée par des interprètes communautaires d'Appartenances.*

## **Bëni kujdes në faktin që :**

Të drejtat e ndryshme që viktimë ka, i nënshtrohen një afati të caktuar ankimi. Sipas tipit të shkeljes së ligjit për shëmbull, afati për të bërë një ankim penal mund të jetë 3 muaj ose më shumë.

Qendra LAVI ju lejon, sipas disa kushteve, (autor jo i njohur, një person që nuk i ka larë borxhet, i aratur, etj.) të merrni nga ana e kantonit, ku ka ndodhur shkelja e ligjit, një dëmshpërblim (dëm moral, neni 19 dhe 22, LAVI). Kërkesa për dëmshpërblim duhet të jetë adresuar brenda një afati pesë vjeçar, ku llogaritet data e shkeljes së ligjit e fundit, me përjashtime (neni 25, LAVI).

Nëqoftëse ky afat ka kaluar, pretendimet tuaja janë fatkeqësisht të pa konsiderueshme (i ka dalë afati i ankimit).

**Në rastin kur viktimë është një fëmijë nën moshën 18 vjeç, afati i ankimit shkon deri në moshën 25 vjeçare, të viktimës.**

## **Nëqoftëse një procedurë penale është hapur, viktimë ka disa të drejta : ajo mund të kërkojë :**

- Autoriteteve (polici, prokuror) të bëjnë të njohur adresën dhe numrin e telefonit vetëm me pëlqimin e saj. (neni152, al.1 e 3 CPP).
- Të mos ballafaqohet me autorin e aktit të dhunës (neni152, al. 3CPP). Në rastin kur shkelja e ligjit është kundër ndershmërisë seksuale, një ballafaqim mund të jetë i detyrueshëm, kundër vullnetit të viktimës (neni 153, al. 2 CPP).
- Në rastin e një shkelje ligji kundër ndershmërisë seksuale, ka të drejtë të kërkojë që të merret në pyetje nga një person i të njëjtit seks, qoftë në qendrën LAVI, në polici ose tek prokurori (neni153, al.1 CPP).
- Për tu paraqitur në polici, tek prokurori, ka të drejtë të shoqërohet nga një person që ka besim, të cilin e ka zgjedhur vetë. Nënpunësat e qendrës LAVI mund të luajnë këtë rol. (neni152, al. 2 CPP).

## **Viktima ka gjithashtu të drejtë ose mundësi :**

- Të shkojë në qendrën e konsultimit të kantonit të zgjedhur prej saj, ku mund të marri informacione, këshilla, mbështetje dhe ndihmë financiare në rast nevojë.
- Të marrë një vendim juridik, të bejë ankim dhe të jetë e informuar.
- Të vërë në dukje pretendimet civile (dëmshpërblim) në procedurën penale (neni 122, deri 126 CPP).
- Të kërkojë caktimin e një avokati shtetëror (paguar nga kantoni, pa detyrim rimbursimi) ose një prokuror i ngarkuar në anketën penale. (neni 136 CPP).
- Etj.